

LIGJ
Nr. 92/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008,
“PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 23 shtohen pikat 23/1 dhe 23/2 me këtë përmbajtje:

“23/1. “Ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike” ka të njëjtin kuptim, sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.

23/2. “Publikimi elektronik” ka të njëjtin kuptim, sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 2

Në nenin 8, shkronja “k” riformulohet si më poshtë:

k) administron domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.”.

Neni 3

Në nenin 12, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. AKEP-i bashkëpunon me AMA-n në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore, si dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s, duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojnë aktet/vendimet përkatëse të këtyre autoriteteve, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 4

Në nenin 137, në fund të kreut V, pas pikës 19 shtohet pika 20 me këtë përmbajtje:

“20. Nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it, që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4, të këtij ligji.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 18.12.2019